

VENDIM
Nr. 199, datë 15.3.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA AGJENCIA E TRAJTIMIT TË
KREDIVE TE MINISTRIA E FINANCIVE, PËR DEGËN E THESARIT SARANDË, TË
NJË AMBIENTI NË PRONËN NR. 13/125-M7, NË ZONËN KADASTRALE 8641, ME
VENDNDODHJE NË ADRESËN “LAGJJA NR. 1”, NË QYTETIN E SARANDËS, DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 513, DATË 15.8.2007, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË FINANCIVE PËR AGJENCINË E TRAJTIMIT TË
KREDIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Agjencia e Trajtimit të Kredive të Ministria e Financave, për Degën e Thesarit Sarandë, të një ambienti me sipërfaqe 25 m², me numër pasurie 13/125-M7, në zonën kadastrale 8641, me vendndodhje në adresën “Lagjja nr. 1”, në qytetin e Sarandës, sipas planvendosjes dhe hartës treguese që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit e miratuar me vendimin nr. 513, datë 15.8.2007, të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Trajtimit të Kredive dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHKATON
PËRQI ZYRES URBANIT




PLANIMETRIA E ZYRES
PENSIONERE SHC: 1-200

PER DEGENE BANA
DREKTOR
ADRIAN

DUKO
POLINER

VENDOSJES SE LOKALIT
PENSIONESH - PARANDE SHC: 1-500



ZIMET

- 1. BANESE
- 2. FARMACI PRIVATE
- 3. DORR I PALLATIT
- 4. SHKALLA E VERTIKALE

SHKURTESI DREKTE

1. Objekti është i rimborsuar për të bënë me këhim për vlerë nga ana përcaktimore e tij.
2. Objekti është materializuar me murez puritë qëllendur.
3. Objekti është, dyerë shtrëngje detyrues, shtrëngje pëllasë qëllendur, me zgjedhje shkurtes.
4. Si përfaqësojë shkurtesimi = 104 m² (30.8 m²)
5. Shkurtesimi = 82.5 m² (21.5 m²)

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

SARANDE

REGJISTRUESE

Adriana SHEHU

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

13/125-N7

ZONA KADASTRALE 8641 NR. I PASURISE VOL. 49 Fq. 179

INDEKSI I HARTES SHKALLA 1:500

ADRESA E PASURISE: Rrethi Sarande Q/F Sarande

Rr/L P/G Sh K Ap

B. KUFIZIMET

V. P.Nr 13/395

L. P.Nr 13/127

J. P.Nr 13/377

P. P.Nr 13/395

C. PRONARI / ET

Agjencia e Trajtitimit te Kredive

Ora: _____

